

  
**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË**  
**MINISTRI**

*Adresa: Bulevardi "Bujram Curri", Nr.1 Tiranë, Shqipëri Tel. ++355 (04) 3262937, [www.moh.gov.al](http://www.moh.gov.al)*

Nr. 70P. Prot

Tiranë, më 15/2 /2010

**URDHËR**

Nr. 32 Datë 15/02/2010

**"Për bashkëpunimin me Urdhrin e Infermjerit"**

Mbështetur në pikën 3. të nenit 116, të "Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë", në ligjin nr. 10107, datë 30.03.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", si dhe në zbatim të neneve 4,5,7 të ligjit nr. 97.18, datë 29.04.2007 "Për urdhrin e infermjerit në Republikën e Shqipërisë" me qëllim përmirësimin e ofrimit të kujdesit infermjeror, si dhe mbrojtjen e popullatës nga kequshtrimi profesioneve infermjere:

**URDHËROJ**

- 1) Të mos punësohet në institucionet shëndetësore publike dhe private, asnjë infermjer - mami - fizioterapeft, pa dokumentin e anëtarësimit të lëshuar nga "Urdhri i Infermjerit".
- 2) Drejtoritë e Institucioneve Shëndetësore, të bashkëpunojnë me strukturat qendrore dhe lokale të "Urdhrit të Infermjerit", në zbatim të ligjit si dhe të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Urdhrit të Infermjerit".
- 3) Ngarkohen Drejtoritë e Institucioneve Shëndetësore Publike dhe Private, për zbatimin e këtij urdhri.
- 4) Cdo urdhër që bie ndesh me këtë urdhër, çfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

